



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. të datës 17.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 14.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën Xhavit Ahmeti dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. të datës 17.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 14.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën Xhavit Ahmeti dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 14.11.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Smart Eng Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 17.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 14.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi i drenazhes dhe sanime tjera në shkollën Xhavit Ahmeti dhe në IEAA tjera" me nr. të prokurimit 616-23-9530-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë buxhet shtesë nga njësia kërkuese, pasi që që projekti është në interes publik. Oferta jonë përmbanë qmimet e tregut duke u bazuar në punet që kanë me u ekzekutu në teren, ku sipas terrenit thellesia e gërmimit për drenazhen e kalon mbi 4 metra dhe drenazhimi duhet te punohet me kujdes te shtuar. Kërkojë nga AK që ta miratoni kërkesen në tërsi dhe të më shpallni fitues sipas dosjes së tenderit pasi që jeni operatori i vetem i përgjegjshëm. Nëse aktiviteti i prokurimit anulohet dhe rishpallet ne prap do te ofertojmë me te njetat qmime".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet sqaruar se arsyet sipas të cilave është eliminuar nga tenderi ka të bëjë me faktin se është tejkaluuar vlera e parashikuar e kontratës. Konkretisht vlera e parashikuar e kontratës është 160,000.00 euro ndërsa parashtruesi ka ofertuar me 184,139.00 euro. Me këtë rast është marrë parasysh rëndësia e këtij aktiviteti të prokurimit dhe nevoja mjaft urgjente për lidhjen dhe realizimin me sukses të kontratës në fjalë. Nga ky këndvështrim, me datë 20.11.2023 njësia kërkuese ka konfirmuar se do të sigurojë buxhetin shtesë të mjaftueshëm i cili është i nevojshëm për të evituar anulimin e panevojshëm të aktivitetit të prokurimit. Mbi bazën e këtij njoftimi përkatësisht konfirmimi nga njësia kërkuese lidhur me buxhetin shtesë, është gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara në tërësi.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj është vendosur që kërkesa për rishqyrtim të miratohet si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.11.2023

Visar SHEHU  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.